1. Sekretariati për Nismën për Transparencë në lndustrinë Nxjerrëse (EITI- Shqipëri) është institucion qendror, person juridik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, që ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar "EITI-Intemational". Sekretariati organizohet si drejtori e përgjithshme dhe e ka seline e tij në Tiranë.

2. Misioni i sekretariatit është përmbushja e prioriteteve dhe strategjive kombëtare për transparencë në industrinë nxjerrëse. Sekretariati koordinon përpjekjet kombëtare, në zbatim të standardit global EITI, që rrjedhin si detyrim nga anëtarësimi, për të siguruar transparencë të plotë të të gjitha taksave dhe pagesave që kryhen nga industritë e naftës, gazit, minierave dhe burimeve të tjera natyrore, me kontribut material në buxhetin e shtetit, proceseve respektive si dhe përgatitjen e menaxhimit të projekteve, në lidhje me këto fusha.

3. Detyrat dhe objektivat e sekretariatit, në zbatim të kërkesave të standardeve EITI, janë:

- Ngritja e strukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve të miratuara për EITI-Shqipëri;
- Publikimi i raporteve EITI, garantimi i procesit të auditimit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të miratimit;
- Përcaktimi, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës dhe ministrinë e linjës, i objektivave kombëtare të zbatimit të EITI;
- Rishikimi i bazës ligjore, për të reflektuar në legjislacionin përkatës kërkesat e standardit EITI, si dhe për të evidentuar pengesat e ndryshme për zbatimin e tij;
- Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit, për zbatimin e planit kombëtar për EITI-n, si dhe monitorimi i tyre;
- Publikimi dhe shpërndarja e raporteve;
- Ndjekja e një strategjie komunikimi dhe informimi, referuar standardit global EITI dhe strategjisë kombëtare për transparencë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Ngritja e kapaciteteve/trajnimi i punonjësve shtetërore, i shoqërisë civile, ku përfshihet edhe media, si dhe grupeve të interesit, të lidhura me EITI-n.
- Trajnimi i nëpunësve të EITI-t, në përputhje me programin e zbatimit kombëtar për EITI-Shqipëri;
- Raportimi, para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit dhe të hapave të anëtarësimit;
- Zgjerimi i fushës së veprimit të EITI-t edhe në fusha të tjera të burimeve natyrore;
- Evidentimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme, në lidhje me transparencën dhe antikorrupsionin në industrinë nxjerrëse dhe atë hidroenergjetike.